

**TERMA REFERENCE****EKSPERT/SUBJEKT PËR PRODHIM TË INFOGRAFËVE****Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”**

Instituti i Studimeve Politike (ISP), është duke implementuar projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) organizatë lider si dhe në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ). Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ISP hap thirrjen për angazhimin e një subjekti/eksperti për prodhimin e infografëve.

ISP inkurajon aplikimet nga subjektet dhe kandidatët, të cilët janë të interesuar dhe merren me prodhimin e këtij produkti të dërgojnë një ofertë financiare

**Procesi i përzgjedhjes:**

Përzgjedhja e aplikantit/subjektit më të favorshëm do të jetë e brendshme dhe vendimi do të merret nga një komision vlerësimi prej 3 anëtarësh. Aplikantët mund të paraqesin çdo pyetje shtesë dhe/ose kërkesë për sqarime në formë elektronike në adresën e e-mailit [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com).

Subjektet/ekspertët e interesuar janë të lutur të japin ofertat e tyre që të dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ofertë financiare në GBP
- Shembuj të punëve të mëparshme
- Çmimi i ofruar të jetë në GBP me vlerë totale përfshirë TVSH

**Kriteret:**

- Të kenë një diplomë në shkencë kompjuterike dhe certifikata kualifikimi në fushën e dizajnimit;
- Të jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojnë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike;
- Të kenë eksperience pune në prodhimin e produkteve të visibilitetit;
- Të respektojnë detyrat dhe afatet e vendosura nga ekipi zbatues i projektit;
- Të kenë aftësi individuale dhe profesionale;
- Në rast subjekti, faturat pranohet vetëm të fiskalizuara.

**Specifikimet teknike infografe:**

- Të transmetojnë mesazhet me anë të elementëve të grafikës, imazhit dhe simboleve;
- Sistemi i ngjyrave të jetë CMYK;
- Rezolucioni minimal 300 DPI;
- Formati i dorëzimit JPG dhe PDF;
- Sasia 20 infografe.

Materiali i brendshëm do të përgatitet në bashkëpunim me stafin e ISP .

	JUNE 2024-DECEMBER 2024							JANUARY 2025 -JUNE 2025				
	2024							2025				
	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Jan	Feb	March	April	May
<i>Infogرافs "Alert System" on Integrity Standards (20 infographics)</i>	xx			xx	xx	xx	xx	xx	xx		xxxx	xx

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 21/06/2024 ora 24:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *"ISP Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – prodhim infografësh. Të mos hapet përpara datës së tenderit."*, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *"ISP\_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – prodhim infografësh. Të mos hapet përpara datës së tenderit."*, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

*(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)*

**Instituti i Studimeve Politike**